

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Numër _____

_____Viti

MARRVESHJE
për bursë të nxënësve nga SHMK "Gjimnazi Matematiko- Informatikë"

Lidhur më date ndërmjet:

1. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, me seli në Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup, përfaqësuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës Doc. Dr. Jeton Shaqiri (në tekstin e mëtejshëm : dhënës i bursës) nga njëra anë dhe

1. _____ NGA

_____ me adresë banimi në Rr.

_____ Nr. _____, me SHVAQ

_____, nxënës/se në vitin në SHMSH "Gjimnazi Matematiko-Informatikë" Shkup në vitin shkollor 2022/2023, në (në tekstin e mëtejshëm : shfrytëzues i bursës) nga ana tjetër

Neni 1

Lënda e kësaj marrëveshje është sigurimi dhe shfrytëzimi i bursës për nxënësin I cili është regjistruar në SHMSH "Gjimnazi Matematiko-Informatikë" për vitin shkollor 2022/2023, në përputhje me "Konkursin për ndarjen e bursave për nxënës të rregullt të regjistruar në SHMSH "Gjimnazi matematiko-informatikë" për vitin shkollor 2022/2023" nr. 13-11475/1 të datës 03.08.2022 (në tekstin e mëtejshëm : Konkursi), për përcaktimin e shumës së bursës dhe rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese.

Neni 2

Dhënësi i bursës, në pajtim me Konkursin nga neni 1, shfrytëzuesit e bursës i siguron bursë në shumën mujore prej 3500,00 denarë për periudhën kohëzgjatjes të vitit shkollor për sa kohë shfrytëzuesi i bursës plotëson kushtet e nenit 4 të kësaj marrëveshjeje

Neni 3

Dhënësi i bursës obligohet nga neni 2 I kësaj marrëveshjeje të paguaj në llogarinë e transaksionit të shfrytëzuesit të bursës.

Neni 4

Shfrytëzuesi i bursës obligohet

1.Rregullisht të regjistrojë vitin e ardhshëm të arsimit,të arrijë sukses të përgjithshëm të shkëlqyer në fund të vitit shkollor në përputhje me Konkursin dhe arsimin e mesëm dhe të përfundojë arsimin e mesëm me afatë të parapar me Ligjin për Arsimin e Mesëm

2. Në fillim të çdo viti shkollor, deri te dhënësi i bursës duhet të dorëzojë vërtetim për regjistrim për vitin vijues të shkollimit dhe dëftesë me suksesin e arritur nga viti I kaluar, **më së voni deri më 30 shtator** të çdo viti, deri në përfundimin e arsimit të mesëm.

3. Në rast ndryshimeve, shfaqja e së cilës ndikon në kushtet e fitimit ose shfrytëzimit të së drejtës për bursë, si: ndryshimi i shkollës, ndërprerja e shkollimit të mëtutjeshëm, marrja e bursës ose kredisë nga një institucion ose kompani tjetër, qëndrimi jashtë vendit, si dhe ndryshimet e tjera, shfrytëzuesi i bursës është i detyruar të njoftojë dhënësin e bursës në afat prej 15 ditëve nga dita kur ka ndodhur ndryshimi, në të kundërtën, dhënësi i bursës do të kryejë pagesën për bursat tashmë të paguara.

4. Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes, të dorëzojë numrin e llogarisë së transaksionit, nga cilado bankë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilën dhënësi i bursës do bëjë pagesën e mjeteve nga neni 2 i kësaj marrëveshje.

Neni 5

E drejta e shfrytëzimit të bursë ndërpritet nëse:

- shfrytëzuesi i bursës nuk i *përbush* detyrimet nga neni 4 i kësaj Marrëveshjeje;

- nuk e ka mbaruar vitin shkollor;

- nuk e regjistron vitin vijues të shkollimit dhe më së voni deri më 30 shtator nuk dorëzon vërtetim për vitin vijues të regjistrimit të shkollimit dhe dëftesë me sukses të realizuar nga viti i kaluar

- nuk përfundon shkollimin brenda afatit të përcaktuar me Ligjin për Arsimin e Mesëm;

- ka përfunduar vitin e shkollimit me rezultat më të ulët se ai i parashikuar në konkurs;

- nuk ka dorëzuar llogarinë e transaksionit në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje;

- të fitoj bursë ose kredi nga institucion ose kompani tjetër, për të cilën është i detyruar të njoftojë menjëherë dhënësin e bursës.

Neni 6

Në rast të mosmarrëveshjes , palët kontraktuese pajtohen që për të njëjtën të vendos Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup .

Neni 7

Kjo marrëveshje është e përbërë në tre ekzemplar të njëjtë, prej të cilëve dy për dhënësin e bursës dhe një ekzemplar për shfrytëzuesin e bursës.

Marveshja konsiderohet e lidhur pasi të nënshkruhet nga palët kontraktuese.

**Ministër i Arsimit dhe Shkencës,
Doc.Dr. Jeton Shaqiri**

SHFRYTËZUES I BURSËS

(Emri dhe mbiemri)

(emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit)

DHËNËSI I BURSËS